



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 122/1 prot.

Tiranë, më 31.1.2024

VENDIM

Nr.10, datë 31.1.2024

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI ANALIZËN E SHKAQEVE QË KANË
SJELLË NË VIJIMËSI VENDE TË PAPLOTËSUARA NË POZICIONET E
PUNËS PJSË E SHËRBIMIT CIVIL NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

- Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme, “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Komisionerit për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 11.01.2024, të Komisionerit, Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit (e ndryshuar);
- Në zbatim të Planit Vjetor të Punës së Komisionerit për vitin 2023 dhe të Vendimit nr. 13, datë 10.01.2023, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me vendet e paplotësuara në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”,

në përfundim të procesit të administrimit/analizimit të të dhënave të grumbulluara,

VENDOSA:

1. Miratimin e raportit “Mbi analizën e shkaqeve që kanë sjellë në vijimësi vende të paplotësuara në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në administratën publike”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Gjetjet e këtij raporti të përfshihen në përmbajtjen e raportit vjetor që do t’i dërgohet Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha